**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A**
**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

Nr.________ Prot. Tiranë, më ___ /12/2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

*[Data 22.12.2025]*

Drejtuar: **Operatorit Ekonomik (OE)** ☐ **ose**
*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**"DULE" sh.p.k me nr. Nipti: J82401502P** dhe me adresë: Durrës Lagjja 13, Rruga Lule Bore,Hekurudha, zona kadastrale nr. 8518, numri i pasurise 39/173-N5, Volumi 25, Faqja 187, Plazh, Durrës.

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** ☐
*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** ☐ ***JO*** ***X***

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________
*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** ☐ **JO** **X**

*Nëse po, të jepen dhënat:* ________________________________________
*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

**Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** "**Çela 20 kV për N.Stacione**"

**Numri i referencës: REF-64132-10-08-2025**

**Fondi limit**: **228,915,418.20 (dyqind e njëzet e tetë milionë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë presje njëzet)** lekë pa TVSH ose **2,360,368.23 EUR** (dy milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë euro e njëzet e tre cent)

euro pa TVSH. *Kursi kembimit sipas Bankës së Shqiperisë i datës 08.10.2025 është 97.00 (nëntëdhjetë e shtatë)*, **sasitë sipas shtojcës formularit të ofertës**.

**Kohëzgjatja e kontratës:** Brenda 10 (dhjetë) muajve nga nënshkrimi i kontratës.

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 09.12.2025

[1]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit.

*[***Nr. 79 datë 15 DHJETOR 2025***]*

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

**Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. **OE: "4 A-M" sh.p.k**. me nr. nipti: K92005016L

*Vlera: 206,023,876.38 (dyqind e gjashtë milionë e njëzet e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.*

2. **OE: "DULE" sh.p.k.** me nr. nipti**: J82401502P**

*Vlera: 213,430,000 (dyqind e trembëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH.*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO X

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

OE/BOE me nënkontraktor

[1] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP*

PO ☐ JO X

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Nga pjesëmarrësit është s'kualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

1. **OE: "4 A-M" sh.p.k. me nr. nipti: K92005016L**

*Vlera: 206,023,876.38 (dyqind e gjashtë milionë e njëzet e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.________________________________ ____________________

____________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT*-it
arsyet

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Ofertuesi është skualifikuar pasi nuk ka vërtetuar në sistem plotësimin e kriterit:

**2.3.2** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike. *Në katalog, të markohen në menyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të*

*përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

**Argumentimi**: Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

Autoriteti kontraktor ka hartuar specifikimet teknike të artikujve objekt kontrate bazuar në:

a) nevojat e tij

b) parashikimet e ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, të ndryshuar, (neni 36).

a-1) Lidhur me pikën e parë, në kuadër të vlerësimit të ofertës teknike të paraqitur nga ofertuesit, KVO i referohet argumentimit të specifikimeve teknike të bërë nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e titullarit të autoritetit kontraktor **nr. 700/4 prot, datë 08.10.2025**.

Ndër të tjera, specifikimet teknike të artikullit me emërtesë: **Pajisje DGA portative e kompletuar per analizim te gazrave ne vajin e transformatoreve te fuqisë**, janë hartuar referuar nevojave të AK nisur nga gjendja e transformatorëve si me poshte.

Referuar numrit 185 te N/Stacioneve elektrike të Shpërndarjes dhe rreth 340 transformatore fuqie ne pune, me poshte jepet ne menyre grafike vitet e punes se tyre per cdo 10 vjecar.




Nga tabela grafike e mësiperme kemi këtë % të viteve në punë të transformatorëve të fuqisë:

1. + 55 vjet pune rreth 20% e transformatoreve te fuqise.
2. + 45 vjet pune rreth 17% e transformatoreve te fuqise.
3. + 35 vjet pune rreth 12% e transformatoreve te fuqise.

Nga të dhenat e mësipërme del qe kemi rreth 50% te transformatoreve të fuqisë në gjendje pune që janë nga 35 vite deri 50/60 vite pune , mbi standartet e rekomanduara IEC per jetëgjatësinë e punës së tyre e cila është rreth 20-30 vite.

Referuar problematike të shfaquara ndër vite në transformatorët e fuqisë, si dhe minimizimin e problematikave që mund të lindin nga degradimi i cilësisë së vajit, është menduar që pajisja DGA portative për analizimin e gazrave të cliruara **të ketë një diapazon të gjërë matje analizimi**, për të kapur dhe analizuar problematikat në transformatorët e fuqisë ekzistues që janë mbi 40/50/60 vjet.

Duke krahasuar të dhënat dhe karakteristikat e ofruara pajisja e ofruar krijon këto problematika në analizimin e gazrave të cliruar në vajin e transformatorëve të fuqisë.

1. Nuk realizon një mbulim të plotë, ka rrezik saturimi (mbingopje) në raste të renda me shkarkime të medha.
2. Në rastin e analizimit te gazrave kur **diapazoni dhe klasa e saktesise se matjes se parametrave te gazrave eshte poshte kufirit te kerkuar,** qe mund te shkaktoje problematikat si me poshte:

- **Mbulim i defekteve të rënda, vlerat e gazrave te çliruar** mund të arrijnë vlera të larta (disa mijëra ppm, mbi 10000ppm nga ajo e ofruar), dhe pajisje mund të ngopet dhe të humbasë informacionin kritik.
- Rrezikon **të mos regjistrojë me saktësi** ngjarjet shumë të rënda, qe ndodhin mbi diapazonin 10000ppm

3. Mungon koha e analizimit te gazrave te pajisjes se ofruar.
4. Kapaciteti i rregjistrimit te dhenave.

Kërkesat e mësipërme janë të rëndësishme kur transformatori ka degradim të thellë ose defekte të përsëritura, vitet e gjata ne perdorim te transformatoreve te fuqise ne N.Stacionet e OSSH, ne te cilet do te kryhen analizat gjate periudhes së shërbimeve te remontit dhe mirembajtjes periodike, dhe me diapazonet dhe klasen e matjes te ofruar pajisja eshte e kufizuar ne analizimin e gazrave te cliruar ne vajin e transformatoreve te fuqise, qellimi i te cilit eshte blerja e kesaj pajisje.

b-1) Lidhur me pikën e dytë, KVO konstaton se specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 36 të LPP dhe konkretisht plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë nen, si vijon:

- përcaktojnë qartë karakteristikat e artikujve objekt prokurimi duke iu referuar kërkesave funksionale ose të performancës;
- mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik dhe
- nuk përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Për specifikimet teknike nuk ka patur asnjë kërkesë për sqarim nga operatorët ekonomikë të interesuar për të paraqitur ofertë në procedurë.

Legjislacioni për prokurimin publik përcakton qartësisht se AK ka detyrimin që të shqyrtojë ofertat e paraqitura duke verifikuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike të kërkuara si dhe të kualifikojë vetëm ato oferta që përmbushin të gjithë kërkesat e sipërcituara. Ky detyrim përcaktohet në:

- nenin 92/3 të LPP cituar:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, **vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

- nenin 82/2 të Rr.P.P., cituar:

Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit **pa devijim material**, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. **"Devijimi" është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;**

ii. "Rezervimi" është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

iii. "Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Gjithashtu në dokumentet standarde të tenderit për procedurën e hapur, të miratuara nga APP, në udhëzimet për OE përcaktohet se operatori ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Ofertës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se pasjisja e ofruar nga Operatori Ekonomik: **"4 A-M" sh.p.k**. me nr. nipti: **K92005016L**, nuk plotëson specifikimet teknike si më poshtë:

1. Nuk realizon një mbulim të plotë, ka rrezik saturimi (mbingopje) ne raste te renda me shkarkime te medha.
2. Ne rastin e analizimit te gazrave kur **diapazoni dhe klasa e saktesise se matjes se parametrave te gazrave eshte poshte kufirit te kerkuar,** qe mund te shkaktoje problematikat si me poshte:
    - **Mbulim i defekteve të rënda, vlerat e gazrave te çliruar** mund të arrijnë vlera të larta (disa mijëra ppm, mbi 10000ppm nga ajo e ofruar), dhe pajisje mund të ngopet dhe të humbasë informacionin kritik.
    - Rrezikon **të mos regjistrojë me saktësi** ngjarjet shumë të rënda, qe ndodhin mbi diapazonin 10000ppm
3. Mungon koha e analizimit te gazrave te pajisjes se ofruar.
4. Kapaciteti i rregjistrimit te dhenave.

Referuar sa më sipër në kushtet kur ofertuesi Operatori Ekonomik: **"4 A-M" sh.p.k**. me nr. nipti: **K92005016L**, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e

specifikimeve teknike për artikullin DGA portative, KVO vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga ky ofertues.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik : **"DULE" sh.p.k. me nr. Nipti: J82401502P** me adresë: Durrës Lagjja 13, Rruga Lule Bore, Hekurudha, zona kadastrale nr.8518, numri i pasurise 39/173-N5, Volumi 25, Faqja 187, Plazh, Durrës, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej *213,430,000 (dyqind e trembëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë mijë)* Lekë pa Tvsh është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Tensionit të Lartë OSSH SHA , *me Adresë: Rruga: Gramoz Pashko, Vila Gri Tiranë* - sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit që do t'ju njoftohet nga Autoriteti Kontraktor Përfitues.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO X

Nëse Po ( *Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*).

**TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**DREJTOR I DREJTORISË SË TENSIONIT TË LARTË**
**OSSH SH.A.**

**Olsi NGJELA**